

# Anketa Tremujore e Forcave të Punës

## Tremujori IV, 2013


**Tiranë, më 11 mars 2014:** Gjatë tremujorit të katërt 2013 sipas vlerësimeve të marra nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) numri i të punësuarve 15-64 vjeç në Shqipëri ishte 922.840 persona. Numri i personave të papunë 15-64 vjeç sipas ATFP-së vlerësohet të jetë 189.230 persona. Shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë pune 15-64 vjeç ishte 17%.

Gjatë tremujorit të katërt 2013 në Shqipëri:

- 58,4 % e popullsisë në moshë pune ishte aktive në tregun e punës, pra e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune
- 48,5 % e popullsisë në moshë pune ishte e zënë në punë
- 28 % e të rinjve ekonomikisht aktivë të moshës 15-29 vjeç ishin të papunë
- 17,9 % e popullsisë ekonomikisht jo-aktive e moshës 15-64 vjeç ishin të papunë të dekurajuar

Krahasuar me tremujorin e tretë të po të njëjtit vit shkalla e papunësisë u rrit me 0,1 pikë përqindje.

**Fig. 1 Shkalla e papunësisë Tr.1/12-Tr.3/13**



**Për publikim 11/03/2014**

**Punësimi**

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës në tremujorin e katërt 2013, ishte 58,4 %, duke shënuar një ulje prej 0,3 pikë përqindje kundrejt tremujorit të tretë të të njëjtit vit.

Ky tregues ishte 47,6 % për femrat dhe 70,3 % për meshkujt. Krahasur me tremujorin e tretë 2013, pjesëmarrja e femrave në tregun e punës është ulur me 1,3 pikë përqindje, ndërsa pjesëmarrja e meshkujve është rritur me rreth 1,0 pikë përqindje.


Gjatë tremujorit të katërt 2013 shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ishte 38,9 % ndërsa për popullsinë 30-64 vjeç ky tregues ishte 69,4 %.

Për popullsinë në moshë pune (15-64 vjeç) vihet re një rënie në shkallën e punësimit nga 48,8 % në tremujorin e tretë në 48,5 % në tremujorin e katërt 2013. Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç gjatë tremujorit të katërt 2013 shkalla e punësimit ishte 28 % ndërsa për popullsinë 30-64 vjeç ky tregues ishte 60 %. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm pati një rritje prej 0,6 pikë përqindje në shkallën e punësimit të të rinjve.

Krahasuar me tremujorin e mëparshëm punësimi në tremujorin e katërt të vitit 2013 pati një rënie të lehtë prej 0,6 %. Kontributin më të madh në rënie e punësimit e zë sektori i ndërtimit ku punësimi ka patur një trend në rënie përgjatë gjithë vitit 2013. Karahasuar me tremujorin e mëparshëm punësimi në sektorin e ndërtimit u ul me 6 %. Tkurrja e punësimit në sektorin e ndërtimit në terma vjetorë vlerësohet të jetë 25 %.

Në tremujorin e katërt 2013, punësimi në industrinë përpunuese u rrit me 1 % krahasuar me tremujorin e tretë dhe zinte 8 % të punësimit total.

**Fig. 2 Shkalla e punësimit Tr.1/12 - Tr.4/13**



Sipas të dhënave të ATFP, vlerësohet se 23,5 % e të punësuarve në tremujorin e katërt 2013 punuan në sektorin e shërbimeve të tregut (tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilave, hotelet dhe restorantet, transportet, magazinimi dhe komunikacioni, ndërmjetësimi monetar dhe financiar, pasuritë e patundshme). Numri i të punësuarve në sektorin e shërbimeve të tregut u rrit me 5% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2013.

Punësimi në sektorin e shërbimeve jo të tregut (administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror, arsimi, shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale, aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual, shërbime në shtëpi, aktivitete të organizmave ndërkombëtare) përbënte 17 % të punësimit total. Në këtë sektor në tremujorin e katërt të vitit 2013 pati një rënie të punësimit prej 1 % krahasuar me tremujorin pararendës.


Gjatë tremujorit të katërt 2013, pesha që zënë në punësimin total të punësuarit me pagë ishte 42,6 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013 numri i të punësuarve kundrejt një page u rrit me 0,7 %. Në grupin e të punësuarve kundrejt një page 58,6 % e të punësuarve janë meshkuj kundrejt 41,4 % që janë femra. Gjatë tremujorit të katërt 2013, 24,4 % e të punësuarve ishin të vetëpunësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar, pa të punësuar të tjerë me pagë), ndërsa punëtorët pa pagesë që punojnë në biznesin e familjes së tyre, përbënin 33 % të punësimit total.

### **Papunësia**

Në tremujorin e katërt të vitit 2013 numri i të papunëve i vlerësuar sipas anketës së forcave të punës ishte 189.230 persona. Shkalla e papunësisë ishte 17 %, duke mbetur pothuajse në nivel të ngjashëm me tremujorin paraardhës i cili ishte 16,9 %. Vihet re se gjatë këtij tremujori shkalla e papunësisë për meshkujt e moshës 15-64 vjeç pati një rënie prej 0,4 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2013, ndërsa për femrat shkalla e papunësisë lëvizti në kah të kundërt duke pësuar një rritje prej 0,8 pikë përqindje.

Gjatë tremujorit të katërt 2013 shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç u rrit nga 26,9 % që ishte në tremujorin e mëparshëm në 28,1%. Ndër të rinjtë e papunë 61,7 % ishin të papunë prej një viti a më shumë. Duke analizuar papunësinë e të rinjve sipas nivelit arsimor të tyre, vlerësohet që 29 % e të rinjve të papunë ishin me arsim të lartë, ku meshkujt e papunë me arsim të lartë përbënin 11 % dhe femrat 18 % të të papunëve gjithsej.


**Fig. 3 Shkalla e papunësisë sipas gjinisë Tr.1/12-Tr.3/13**



Për popullsinë 30-64 vjeç në tremujorin e katërt të vitit 2013 shkalla e papunësisë ishte 13,5 %.

Shkalla e papunësisë afatgjatë për popullsinë 15-64 vjeç ishte 12 % për meshkujt dhe 11 % për femrat.

Përsa i përket mënyrave të kërkimit për punë, personat e papunë u pyetën për 13 alternativa të mundshme të cilat janë të lidhura me hapat specifike të kërkimit aktiv për punë.



Mënyrat që përdoren më së shumti për të gjetur një punë janë aplikimi direkt tek ndonjë punëdhënës (64,6 %), u drejtohen të afërmeve, miqve/shokëve (87 %), kontaktojnë Zyrat Publike të Punësimit (28 %), studiojnë lajmërimet në gazeta (18,4 %), vendosin ose u përgjigjen lajmërimeve në gazeta (17,5 %).

**Popullsia ekonomikisht jo-aktive**

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2013 popullsia e moshës 15-64 vjeç e klasifikuar si ekonomikisht jo-aktive përbënte 41,6 % të popullsisë në moshë pune. Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që deklaruan se ishin nxënës/studentë ose në trajnim përbënin 60,2 % të të rinjve ekonomikisht jo aktivë.

Gjatë tremujorit të katërt 2013, rreth 18.4 % e popullsisë ekonomikisht jo aktive e moshës 15-64 vjeç ishte duke përmbushur detyrat shtëpiake. Brenda grupit të personave ekonomikisht jo-aktive për shkak të detyrimit për përmbushjen e detyrave shtëpiake meshkujt zënë vetëm 1,4 %.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2013, të papunët e dekurajuar përbënin 17,9 % të popullsisë së moshës 15-64 vjeç ekonomikisht jo-aktive. Në grupin e personave që nuk po kërkonin punë pasi mendonin që nuk ka punë të disponueshme rreth 60 % e tyre ishin me arsim tetëvjeçar dhe 36 % ishin me arsim të mesëm (profesional ose të përgjithshëm).

Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç të klasifikuar si të papunë të dekurajuar përbënin 11,5 % të të rinjve ekonomikisht jo-aktivë gjithsej.

**Tab. 1 Shkalla e papunësisë Tr.1/12 - Tr.4/13**

Mosha	Gjinia	Tr.1.2012	Tr.2.2012	Tr.3.2012	Tr.4.2012	Tr.1.2013	Tr.2.2013	Tr.3.2013	Tr.4.2013
15 vjeç e lart	Total	12,9	13,4	13,5	13,9	13,9	15,4	16,5	16,7
	Meshkuj	13,8	14,5	14,6	15,0	15,0	17,4	18,8	18,5
	Femra	11,8	12,0	12,1	12,4	12,4	12,7	13,4	14,2
15-64 vjeç	Total	13,4	13,9	14,0	14,4	14,4	15,8	16,9	17,0
	Meshkuj	14,3	15,1	15,1	15,6	15,6	18,1	19,3	18,9
	Femra	12,2	12,4	12,6	12,8	12,8	13,0	13,7	14,5
15-29 vjeç	Total	22,9	24,1	27,3	26,0	26,0	26,4	26,9	28,1
	Meshkuj	23,6	26,4	30,2	29,5	29,5	30,6	30,4	28,3
	Femra	21,8	20,4	22,8	20,7	20,7	19,8	21,5	27,6
30-64 vjeç	Total	10,0	10,2	9,3	10,5	10,5	12,7	14,0	13,5
	Meshkuj	10,6	10,5	9,3	10,5	10,5	13,9	15,8	15,6
	Femra	9,2	9,9	9,4	10,4	10,4	11,2	11,8	10,9

**Tab. 2 Shkalla e punësimit Tr.1/12 - Tr.4/13**

Mosha	Gjinia	Tr.1.2012	Tr.2.2012	Tr.3.2012	Tr.4.2012	Tr.1.2013	Tr.2.2013	Tr.3.2013	Tr.4.2013
15 vjeç e lart	Total	52,0	50,5	49,4	48,6	48,6	44,7	43,1	42,6
	Meshkuj	58,0	57,0	56,1	55,4	55,4	51,4	49,5	50,2
	Femra	46,1	44,0	42,8	41,9	41,9	38,5	37,2	35,7
15-64 vjeç	Total	58,8	56,9	55,2	54,5	54,5	50,5	48,8	48,5
	Meshkuj	65,1	63,7	62,2	61,6	61,6	57,8	56,0	57,0
	Femra	52,6	50,1	48,2	47,3	47,3	43,9	42,2	40,7
15-29 vjeç	Total	39,4	37,7	33,2	32,8	32,8	28,0	27,4	28,0
	Meshkuj	44,9	42,8	37,5	36,5	36,5	32,8	32,4	35,3
	Femra	33,5	32,2	28,7	28,8	28,8	23,4	22,5	21,0
30-64 vjeç	Total	69,4	67,6	67,8	66,9	66,9	63,2	60,6	60,0
	Meshkuj	76,9	76,1	77,2	76,9	76,9	72,6	69,6	69,7
	Femra	62,2	59,4	58,9	57,4	57,4	54,9	52,7	51,4

**Tab. 3 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës Tr.1/12 - Tr.4/13**

Mosha	Gjinia	Tr.1.2012	Tr.2.2012	Tr.3.2012	Tr.4.2012	Tr.1.2013	Tr.2.2013	Tr.3.2013	Tr.4.2013
15 vjeç e lart	Total	59,7	58,3	57,1	56,4	56,4	52,8	51,6	51,2
	Meshkuj	67,3	66,7	65,6	65,2	65,2	62,3	60,9	61,5
	Femra	52,2	50,0	48,7	47,8	47,8	44,1	43,0	41,6
15-64 vjeç	Total	67,9	66,1	64,2	63,6	63,6	60,0	58,7	58,4
	Meshkuj	76,0	75,1	73,2	73,0	73,0	70,5	69,5	70,3
	Femra	59,9	57,2	55,2	54,3	54,3	50,4	48,9	47,6
15-29 vjeç	Total	51,1	49,6	45,7	44,3	44,3	38,1	37,4	38,9
	Meshkuj	58,8	58,2	53,7	51,8	51,8	47,3	46,6	49,3
	Femra	42,9	40,4	37,1	36,3	36,3	29,2	28,6	29,0
30-64 vjeç	Total	77,1	75,3	74,8	74,7	74,7	72,3	70,5	69,4
	Meshkuj	86,1	85,0	85,1	85,9	85,9	84,3	82,6	82,6
	Femra	68,6	65,9	65,0	64,1	64,1	61,8	59,7	57,7

**Shënim:**

Standardet ndërkombëtare të matjes së treguesve të tregut të punës u ndryshuan në Konferencën e 19-të Ndërkombëtare të Statisticienëve të Punës, Gjenevë, tetor 2013.

Duke u bazuar në rezolutën e miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës në këtë konferencë në lidhje me statistikat e punëzënies, punësimit dhe nënpërdorimit të punës, INSTAT po konsideron mundësinë e zbatimit të këtyre standardeve të reja në vijim.

Për informacione të mëtejshme lidhur me këtë rezolutë klikoni në linkun e mëposhtëm:

<http://ilo.org/global/statistics-and-databases/standards-and-guidelines/lang--en/index.htm>

# Metodologjia

Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) është një vrojtim statistikor që kryhet pranë familjeve. Objektivi kryesor i saj është të japë informacion mbi situatën e tregut të punës në Shqipëri i cili përdoret për të hartuar politikat e tregut të punës dhe për vlerësimin e efektshmërisë së tyre, si dhe për të kënaqur nevojat e përdoruesve të statistikave për të dhëna të përditësuara mbi dinamikën e tregut të punës.

Në vitet 2007-2011 Anketa Tremujore e Forcave të Punës është kryer nga INSTAT me periodicitet vjetor. Në vitin 2012, Anketa Tremujore e Forcave të Punës u projektua si një anketë pilot për marrjen e vlerësimeve tremujore për punësimin dhe papunësinë në nivel kombëtar. Nga tremujori i parë 2013 e në vazhdim, INSTAT publikon tregues mbi tregun e punës të vlerësuar bazuar në të dhënat e anketës së forcave të punës me periodicitet tremujor.

Për ATFP përdoret një strukturë panel e alternuar zgjedhjeje, përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në kampion për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Intervistat për të njëjtën familje janë planifikuar të kryhen ekzaktësisht pas 13 javëve, kështu intervista e pestë kryhet një vit më pas intervistës së parë. Sipas strukturës panel të përdorur, në çdo tremujor një e pesta e familjeve të zgjedhura janë të reja dhe 80 përqind e familjeve janë të njëjta. Pra, në çdo tremujor në kampionin e zgjedhur për anketën shtohen 1.008 familje të reja dhe hiqet po i njëjti numër familjesh pasi është intervistuar në 5 tremujorë të njëpasnjëshëm.

Masa e kampionit të zgjedhur për anketim është 5.040 familje për çdo tremujor. Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe ku në hapin e parë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave gjeografike (të zgjedhura në hapin e parë) zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 8 familjesh.

Mbledhja e të dhënave në terren bëhet përgjatë gjithë muajve të vitit. Në familjet e zgjedhura u anketuan nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë të gjithë pjesëtarët në moshë 15 vjeç e lart. Pyetësi i ATFP është hartuar me asistencën teknike të EUROSTAT dhe ai është në përputhje të plotë me rekomandimet dhe rregulloret e EUROSTAT. Nga ana metodologjike anketa plotëson kërkesat e EUROSTAT-it si ato që lidhen me përfaqësimin e kampionit, koeficientët e variacionit të treguesve kryesorë, hartimin e pyetësorit, si dhe me procedurat e peshimit të të dhënave.

**Të punësuar** janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës.

**Java e referencës** është java kalendarike nga e hëna në të dielë para datës së intervistës

Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës, si dhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkohshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trainim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50 përqind ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum, janë konsideruar të punësuar.

**Të papunë** konsiderohen personat që ishin:

- a) pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi.
- b) aktualisht të disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës).
- c) duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifike të ndërmarrë për të kërkuar punë konsiderohen rastet kur kanë:

- kontaktuar me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë
- kontaktuar me një agjensi private punësimi për të gjetur punë
- aplikuar direkt pranë ndonjë punëdhënësi
- kërkuar miqve/shokëve, të afërmve, sindikatave etj.
- vendosur ose u janë përgjigjur lajmërimeve në gazeta
- studiuar lajmërimet në gazeta



- marrë pjesë në një test apo intervistë
- kërkuar për tokë, godinë ose pajisje
- aplikuar për leje, liçenca ose burime financiareaplikuar për leje, liçenca ose burime financiare

**Popullsia në moshë pune** është popullsia 15-64 vjeç.

**Forca e Punës** përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

**Popullsia jo-ekonomikisht aktive** përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtepiakë, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

**Shkalla e punësimit** është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

**Shkalla e papunësisë** është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

**Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës** është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.